



### ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E OKB, SHQIPËRIA DËNON VEPRIMET STALINISTE TË RUSISË NDAJ UKRAINËS

Në kuadër të javës së Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, MEPJ Olta Xhaçka, mori pjesë në disa prej eventeve më të rëndësishme të zhvilluara në Nju Jork, si dhe zhvilloi një sërë takimesh dypalëshe. Gjatë konferencës në Këshillin e Sigurimit të OKB mbi “Ruajtjen e Paqes dhe Sigurisë në Ukrainë”, ministrja Xhaçka theksoi se misionet për gjetjen e fakteve tregojnë një brutalitet të tmerrshëm kriminal kundër popullatës civile ukrainase dhe se Komuniteti Ndërkombëtar duhet ta mbajë Rusinë përgjegjëse për këto akte. E pranishme në eventin ministror “E drejta për të qenë unë”, ku ishte i pranishëm edhe Sekretari i Shtetit, Antony Blinken, MEPJ Olta Xhaçka theksoi se Shqipëria mbetet e përkushtuar dhe e vendosur për ta çuar përpara agjendën për të drejtat e komunitetit LGBTI, si çështje prioritare edhe në OKB.



### SHQIPËRIA MBËSHTET FORCIMIN E RRJETIT TË AVOKATËVE TË BARAZISË GJINORE

Gjatë konferencës “Formimi i Politikës së Jashtme Feministe” që u mbajt në Berlin, Ministrja Xhaçka përgëzoi homologen gjermane, Annalena Baerbock, për iniciativën e ndërmarrë, e cila sipas saj synon të zgjerojë dhe forcojë rrjetin e avokatëve të barazisë gjinore.



### SEEC/ MINISTRJA XHAÇKA: BASHKËPUNIMI RAJONAL, KYÇ PËR PERSPEKTIVËN TONË EVROPIANE

MEPJ Olta Xhaçka, mori pjesë në takimin e Ministrave të Jashtëm të SEECP që u mbajt në Nju Jork, ku theksoi se është koha që rajoni ynë të bëhet bashkë dhe të bashkëpunojë në të mirë të popullit dhe perspektivës evropiane.



### NËNSHKRUHET MARRËVESHJA PËR HEQJEN E VIZAVE MES SHQIPËRISË DHE KAZAKISTANIT

MEPJ Olta Xhaçka dhe Ministri Tileuberdı Mukhtar, nënshkruan në Nju Jork marrëveshjen për heqjen e vizave mes Shqipërisë dhe Kazakistanit. Ministrja Xhaçka u shpreh se kjo marrëveshje do të kontribuojë në intensifikimin e mëtejshëm të bashkëpunimit dypalësh dhe në lirinë e lëvizjes.



### MARRËVESHJET PËR SIGURIMET SHOQËRORE, SHQIPËRIA PROGRES ME PALËN GREKE DHE KROATE

Shqipëria dhe Kroacia përfunduan raundin e parë të negociatave për marrëveshjen e sigurimeve shoqërore, nga e cila do të përfitojnë rreth 3 mijë shqiptarë që punojnë në Kroaci. Komisioni i ekspertëve të Shqipërisë dhe Greqisë kanë zhvilluar mbledhjen e parë të tyre për çështjet e sigurimeve shoqërore, i cili është një hap tejet pozitiv në forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe për arritjen e marrëveshjes së pensioneve.